



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-17984 dt. 19/05/ 2026

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

th ë r r e t

mbledhjen e **rregullt** të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më **datë: 29.05.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt.30.04.2026.
2. Të ndryshme.

Drenas, 19.05.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burimë Burupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-1798 dt. 19/05/2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 30.04.2026, e cila filloi në orën 10:28.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Burim Bujupi**, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 25 anëtarë.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, anëtarët e Kuvendit, Ekrem Elshani (PDKRLL), Naim Gjeli (PDKRLL), Anjeza Kurtaj (PDKRLL), Selman Qallapeku (PDKRLL), Valdet Curri (PDKRLL), Qëndresë Xhema (PDKRLL), Gani Krasniqi (PDKRLL), Erblinë Morina (PDKRLL), Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Driton Ajazi (PDK), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Artian Krasniqi (PDK), Tringa Bujupi (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Xhavit Drenori (GREEN, Arbër Halilaj (BD), Mehedin Salihu ((Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (LDK), Liman Krasniqi (NISMA).

Munguan: Edon Nishori (PDKRLL), dhe Mërgim Pirraku (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, stafi i Zyrës së Kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale, si dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi theksoi se, para fillimit të mbledhjes së rregullt, në nderim të 27-vjetorit të rënies së heroit Ilaz Kodra, 42 dëshmorëve dhe mbi 280 martirëve të rënë më 30 prill 1999 në fshatrat Vërboc, Shtuticë, Dashec, Baks, Gllobar, Tërstenik, Polluzhë dhe në fshatrat përreth, u mbajt një minutë heshtje nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Mbledhja do të ketë këtë

REND DITE:

1. Procesverball i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 30.03.2026;
2. Propozim-vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit në mjedis 2026–2030;
3. Propozim-vendim për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit (Glllogocit) 2026–2028;
4. Propozim-vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë;
5. Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për drejtorë në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit;
6. Propozim-vendim për themelimin e komisionit për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin nr. 02-462/01-77929 të dt. 27.02.2026, për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë/juridikë (deri në 99 vite);
7. Propozim-vendim për themelimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
8. Raporti financiar janar–mars 2026;
9. Propozim-vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga tejkalimi në vitin 2025 për t'u bartur në vitin 2026, dhe bartjen e fondeve – bilancet e pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026;
10. Propozim-vendim për formimin e komisionit për plotësim-ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba;
11. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi **kryesues i Kuvendit Burim Bujupi**, i cili hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës, ku fjalën ia dha kryetarit.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, lidhur me kërkesën e z. Arigon Sinanit në mbledhjen e KPF-së për formimin e një komisioni për rishikimin e lejeve ndërtimore, unë kam një propozim shtesë. Sa i përket përgjegjësive tona ndaj qytetarëve dhe ligjit, dua të theksoj se, ne i nënshtrohemi kontrolleve nga auditorët e jashtëm dhe të brendshëm të paktën tri herë brenda vitit, ndryshe nga shumë komuna të tjera dhe në asnjë rast nuk është konstatuar asnjë shkelje. Megjithatë, nëse dëshironi të iniciojmë krijimin e një komisioni *ad-hoc* për lejet ndërtimore në Komunën e Drenasit, konsideroj se për të siguruar transparencë të plotë dhe paanshmëri, ky komision duhet të trajtojë në mënyrë gjithpërfshirëse këto çështje. Të rishikohen të gjitha lejet e lëshuara që nga viti 1999. Procesi i blerjes, pagesat përkatëse, borxhet e mbetura për këto lokale dhe mosrespektimi i vendimeve gjyqësore, lejet ndërtimore dhe ato për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve në komunën tonë. Objektet e bizneseve të ndërtuara ndër vite pa leje, mbindërtimet apo tejkalimet në pronat publike. Devijimet e lumenjve Drenica dhe Verbica, si dhe kthimi i tyre në shtratin natyror sipas vendimeve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Lejet për ndarjen e trojeve për familjet e dëshmorëve dhe kthimi i ligjshmërisë nga MAPL-ja.

Uzurpimet e pronës publike, me theks të veçantë atë në Stacionin e Autobusëve. Kërkoj që të gjitha këto çështje të shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse ju vendosni për formimin e këtij komisioni, unë do ta përgatis propozim-vendimin menjëherë, pasi jam i përkushtuar për transparencë maksimale.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, fjala për z. Xhavit Drenori, mirëpo për shkak të problemeve teknike, zëri i tij nuk u dëgjua (nuk u regjistrua).

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, ky komision *ad-hoc* ka për qëllim identifikimin e parregullsive dhe defekteve në vendimmarrje ndër vite. Ekzistojnë vendime të shumta të marra nga kuvendet në legjislatura të ndryshme, të cilat nuk janë dërguar fare për vlerësim të ligjshmërisë, por janë ekzekutuar menjëherë nga zyrat brenda institucionit të Komunës. Ka raste kur janë legalizuar prona dhe shtëpi mbi bazën e këtyre vendimeve, të cilat u janë ndarë personave të caktuar apo familjeve të dëshmorëve. Ky komision do të kërkojë të gjithë dokumentacionin për proceset ku dyshohet se ka pasur shkelje, duke përfshirë lejet ndërtimore dhe trojet e ndara në emër të familjeve të dëshmorëve.

Liman Krasniqi theksoi se, nëse mendohet të formohet një komision i tillë, duhet t'i kemi parasysh detyrat dhe përgjegjësitë që po i ngarkojmë. Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i caktojmë detyra që faktikisht nuk i takojnë apo janë të pamundura për t'u realizuar. Nëse ky komision do të trajtojë të gjitha shkeljet e pretenduara që nga periudha e pasluftës e deri më sot, ashtu siç propozoi Kryetari, atëherë as për tetë vite punë ai komision nuk do të mund t'i përfundonte obligimet e veta, e lëre më brenda mandatit tonë katërvjeçar.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, unë besoj se nëse formohet ky komision dhe ekziston vullneti i duhur, punët mund të kryhen shpejt, pasi shumicën e dokumentacionit e kemi të gatshëm.

Arigon Sinani tha se, këtë propozim e ka zgjeruar parafolësi, pasi unë kam kërkuar një komision tjetër. Komisioni që kam kërkuar unë ka të bëjë me verifikimin e lejeve të ndërtimit. Ne mund të formojmë çfarëdo komisioni vetëm mos thuaj që ka kërkuar Arigoni.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, unë e ngrita këtë temë që të mos pretendojë dikush se Kryetari u frikësohet komisioneve *ad-hoc*. Pikërisht për këtë arsye, propozova që të shqyrtohen të gjitha çështjet në tërësi.

Liman Krasniqi tha se, nëse kjo çështje përfshihet si pikë e rendit të ditës, duhet të hyjë ashtu siç është propozuar fillimisht nga anëtarë i Kuvendit. Ne mund t'i verifikojmë lejet e ndërtimit që nga paslufta, mirëpo zgjerimi i tepërt i fushëveprimit të komisionit mund të çojë në mungesë rezultatesh në fund.

Egzona Tërdevci kërkoi që, nëse z. Arigoni ka pasur një propozim në KPF, por nuk e ka paraqitur sot në rend dite, kërkoj që të na dërgohet me shkrim neve si asamblistë. Po ashtu edhe Kryetari t'i paraqesë me shkrim pikat që ai mendon se duhet të trajtohen nga ky komision. Konsideroj se një komision që ngarkohet me të gjitha ato çështje nuk do të ketë kapacitet për t'i

trajtuar ato siç duhet. Duhet të përcaktohet qartë fushëveprimtaria, sepse nëse grumbullohen të gjitha në një vend, do të mbetet pa u trajtuar asgjë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pas diskutimeve të zhvilluara dhe në mungesë të një emërtimi të dakorduar për propozimin e Kryetarit dhe të z. Sinani (çështje e cila u diskutuar në Komitetin për Politikë dhe Financa), propozoi që këtë pikë ta shtyjme për seancën e ardhshme. Ndërkohë si pikë e re e rendit të ditës shtohet. Propozim-vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Asociacionit, pas dorëheqjes së z. Xhavit Drenori për arsye personale dhe profesionale.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, i hodhi në votim pikat e propozuara të rendit të ditës. Në momentin e votimit, të pranishëm ishin 25 anëtarë. Rezultati i votimit ishte. Për votuan 25, kundër 0, abstenime 0. Rendi i ditës miratohet unanimisht me ndryshimet e propozuara.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutim për pikën e parë të rendit të ditës. **Pika (1)** Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 30.03.2026. Pasi konstatoi se nuk ka diskutime nga anëtarët e Kuvendit, kryesuesi e hodhi në votim pikën e parë. Për votuan **25**, kundër **0**, abstenim **1**.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e dytë. **Pika (2)** Propozim-vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit në mjedis 2026–2030. Në mungesë të diskutimeve, pika u hodh në votim nga kryesuesi. Për votuan **23**, kundër **0**, abstenime **2**.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e tretë. **Pika (3)** Propozim-vendim për miratimin e Planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Drenasit (Gllogocit) 2026–2028.

Egzona Tërdevci bëri një pyetje lidhur me këtë pikë. A posedojmë ne si komunë një bazë të dhënash (databazë) me numrin e saktë të personave të riatdhesuar. Gjatë leximit nuk kam parë që këto të dhëna të jenë përfshirë si pjesë e strategjisë.

Shefja e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Afije Veseli tha se, zyra jonë përgatit rregullisht raporte gjashtëmujore dhe vjetore për Zyrën e Kryetarit. Sipas të dhënave tona, gjatë vitit 2025 janë ri-integruar 38 familje, ndërsa gjatë pjesës së deritanishme të vitit 2026, janë ri-integruar 7 familje.

Xhavit Drenori pyeti se, nga ajo që deklaruat, kuptova se 38 familje janë paraqitur në Komunë duke kërkuar të përfitojnë nga fondi i ri-integrimit. Kështu e kuptova unë.

Shefja e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Afije Veseli sqaroi se, fondi për ri-integrim menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim luan rolin e këshillimit dhe koordinimit mes personave të riatdhesuar dhe Ministrisë, pra ne veprojmë si urë lidhëse në koordinim të plotë me MPB-në për t'u ofruar ndihmën e nevojshme këtyre rasteve.

Xhavit Drenori, nëse 38 familje kanë kërkuar të përfshihen në këtë fond gjatë vitit 2025, a është ky numri fiks i atyre që kanë përfituar, apo ka edhe familje të tjera që nuk janë lajmëruar fare në zyrën tuaj. Ne si anëtarë të Kuvendit është mirë t'i kemi këto informata të sakta.

Shefja e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Afije Veseli njoftoi se, ZKK-ja funksionon që nga viti 2011 dhe ka mbajtur fushata të vazhdueshme sensibilizuese. Shumica e personave dhe familjeve të ri-integruara janë të njoftuara për procesin. Një hallkë kryesore e këtij procesi është edhe zyra në Aeroportin e Prishtinës, në momentin e kthimit, këta persona njoftohen menjëherë, pajisen me broshura informuese dhe udhëzohen të paraqiten në komunat e tyre përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, e hodhi në votim pikën e tretë. Për votuan **25**, kundër **0**, abstenime **0**.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt. **Pika (4)** Propozim-vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë.

Egzona Tërdevci mori fjalën për të bërë një pyetje rreth pikës së katërt. *(Për shkak të problemeve teknike me audion, diskutimi i asamblistes nuk dëgjohet në xhirim në minutën 42:59).*

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, u përgjigj se sa i përket pyetjes mbi pronën dhe lokacionin, ne mbetemi të parët dhe nuk kemi ndryshuar asnjë vendndodhje. Megjithatë, kjo pyetje nuk i përket kësaj pike të rendit të ditës, mund ta parashtroni atë te pika Të ndryshme.

Drejtoresha e Shëndetësisë, Kaltrina Qerkinaj sqaroi se, projekti është ende në fazën e planifikimit. Ajo theksoi se prioritet kanë nënat vetushqyese (kryefamiljare). Projekti synon të lehtësojë jetesën e pesë familjeve, përfshirë ato që kanë anëtarë me aftësi të kufizuara ose me sëmundje të rënda kronike. Gjithashtu, u bë e ditur se, Kuvendi Komunal ka kompetencën të miratojë një vlerë bonusi më të lartë se ajo që përcaktohet në nenin 17 të ligjit përkatës.

Mehedin Salihu, kërkoi sqarime shtesë sa është vlera e saktë e këtij bonusi dhe pse është përfshirë një numër aq i vogël familjesh. A ka mungesë aplikimesh, apo nuk ka më shumë se pesë familje që plotësojnë kriteret.

Drejtoresha Kaltrina Qerkinaj, u përgjigj. Vlera totale e bonusit për tri vite ka qenë 18 mijë euro, e ndarë në baza vjetore. Ky fond është siguruar si shpërblim për performancën e mirë të komunës tonë. Fatmirësisht, nuk kemi shumë raste që kanë nevojë për mbulimin e qirasë. Si rregull, nëse qiraja është 200 euro, Komuna mbulon 50% të vlerës dhe familja 50% tjetër, por në rastet kur familja ka një person me aftësi të kufizuara, mbështetja financiare rritet.

Xhavit Drenori, kërkoi sqarime shtesë. A ka ndonjë udhëzim nga Komuna jonë që u tregon qytetarëve se si të përfitojnë nga mbulimi i 50% të qirasë. A mund të kemi të paktën një raport nga drejtorja mbi procedurat, pasi njerëzit kanë nevojë për këtë informacion.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, u përgjigj. Çdo kërkesë që është parashtruar në Kuvendin Komunal ka marrë përgjigje me përgjegjësi të plotë. Kushtet për përfitim janë të specifikuara në propozim-vendim, shihni nenet 2, 3 dhe 4, të cilat e detyrojnë Komunën t'u përmbahet kriterëve. Për çdo kërkesë që vjen nga familjet në nevojë, zyrtarët komunal i ndihmojnë aplikuesit që ta plotësojnë dokumentacionin në mënyrë të saktë. Sigurisht, formohet një komision për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave. Komisioni ka për obligim kujdesin ndaj procesit, ndërsa unë kam për detyrë zbatimin e vendimit.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e katërt (4) Propozim -vendim për lejimin e bonusit të banimit për shfrytëzimin e banesave me qira nga tregu, për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare të bëjnë pagesën e qirasë. Për votuan 25, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë të rendit të ditës. **Pika (5)** Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit.

Egzona Tërdevci, pyeti rreth procesit të përzgjedhjes së drejtorit të shkollës, përkatësisht se mbi çfarë kriteresh Drejtoria Komonale e Arsimit (DKA) e përzgjedh kandidatin e dytë.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka, u përgjigj se propozimi vjen nga DKA-ja dhe miratohet nga Kuvendi. Ai bëhet nëse kandidati është drejtor i një institucioni me performancë të lartë. Zonja në fjalë që është propozuar, ka një performancë të vlerësuar lart, natyrisht pas procesit të vlerësimit që i është bërë.

Mehedin Salihu pyeti se, çfarë vlere ka formimi i këtij komisioni, nëse në fund vendimet ose rekomandimet e tij nuk merren parasysh nga askush.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka, u përgjigj duke thënë se pyetja apo konstatimi i asamblistit përbën paragjykim, prandaj refuzoi të përgjigjet lidhur me këtë çështje.

Xhavit Drenori, pyeti se sa është mandati i kësaj drejtoreshe, a do t'i nënshtrohet edhe ajo një komisioni të tillë ku është vetë kryetare dhe nëse është sqaruar kjo çështje.

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka sqaroi se, mandati i komisionit, ashtu siç është cekur, përfundon me përmbylljen e procedurave të rekrutimit. Me nxjerrjen e vendimit për kandidatin fitues, përfundon edhe mandati i këtij komisioni. Drejtoreshës në fjalë nuk i skadon mandati këtë vit, që do të thotë se ajo nuk i nënshtrohet kësaj procedure.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hodhi në votim pikën e pestë të rendit të ditës: (5) Propozim-vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit. Për votuan 25, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi hapi për diskutim pikën e gjashtë. (6) Propozim-vendim për themelimin e komisionit për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin nr.02-462/01-77929 të dt. 27.02.2026 për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (deri 99 vite).

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi theksoi se, ky komision përbëhet nga pesë anëtarë: tre anëtarë nga Kuvendi, një nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritar. Nga anëtarët e Kuvendit, një i takon PDKRLL-së, një PDK-së dhe një partive të tjera opozitare, ndërsa anëtarët nga ekzekutivi dhe sektori joqeveritar propozohen nga Kryetari.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, anëtarin e ekzekutivit dhe atë të shoqërisë civile i caktoj unë. Për anëtar të ekzekutivit caktoj Petrit Gashin, ndërsa anëtarin e shoqërisë civile po ua lë juve ta propozoni kë të doni, nëse nuk keni propozim, atëherë emrin e jap unë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi kërkoi nga shefi i grupit të PDKRLL-së, Gani Krasniqi, të propozojë anëtarin e tyre.

Shefi i grupit të PDKRLL-së, Gani Krasniqi propozoi Naim Xhelin.

Driton Ajazi deklaroi se, ne si grup nuk dëshirojmë të bëhemi pjesë e këtij komisioni dhe këtyre pazareve që pritet të bëhen me pronat publike.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi u përgjigj se sigurisht që emri do të zëvendësohet me një tjetër ndërkohë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, mori fjalën, është e lehtë të tërhiqesh nga beteja. Të gjithë jeni pajtuar për formimin e komisionit rekomandues që përcakton se cilat prona do të shpallen në konkurs publik. Formimi i këtij komisioni është detyrim ligjor. Ju mund të mos dërgoni emër si grup, por Kuvendi duhet ta zëvendësojë atë me një emër tjetër. Nëse komisioni mbetet me katër anëtarë, MAPL-ja e shpall vendimin të pavlefshëm.

Driton Ajazi u përgjigj. Po e përsëris, ne kemi kërkuar që nga lista të largohen ato prona që janë të destinuara për institucione publike, siç ishin rastet në Drenas dhe Komoran. Kërkesa jonë nuk u mor parasysh, prandaj nuk marrim pjesë në këtë komision dhe vota jonë është kundër.

Xhavit Drenori shtoi se, pas një konsultimi të shkurtër me kolegët e subjekteve të tjera, unë propozoj Egzona Tërdevcin. Megjithatë, nëse ka edhe një vend të lirë, me dëshirë do të bëhesha pjesë e këtij komisioni.

Kryetari Ramiz Lladrovci sugjeroi se, nëse PDK nuk jep emër, ju gjashtë anëtarët e opozitës merrni një pauzë dhe konsultohuni.

Kryesuesi i Kuvendit Burim Bujupi njoftoi se, meqenëse PDK nuk dha emër për anëtarin e komisionit nga Kuvendi, mbledhja shkon në pauzë 10 minuta deri në sigurimin e një propozimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, njoftoi rifillimin e mbledhjes së thirrur për dt. 30.04.2026, duke vazhduar me pikën e gjashtë. **(6)** Propozim-vendim për themelimin e komisionit për vlerësimin e pronave të përfshira në vendimin nr. 02-462/01-77929, të dt. 27.02.2026, për miratimin paraprak të dhënies së pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë/juridikë (deri në 99 vite). Kryesuesi sqaroi. Siç e ceka më herët, sipas përbërjes së Kuvendit, nga tre anëtarët e paraparë, një i takon PDKRLL-së, një PDK-së dhe një VV-së. Meqenëse PDK-ja u tërhoq nga ky komision, për transparencë dhe mirëkuptim, po ia japim të drejtën grupit opozitar që të propozojë një anëtar tjetër. Ju lutem a keni ndonjë emër.

Xhavit Drenori theksoi se, fatkeqësisht, nga ajo që kam vërejtur, ka pasur mungesë interesimi dhe se disa anëtarë janë kundër këtij vendimi, gjë që është e drejtë e secilit. Megjithatë, ai u ofrua vullnetarisht që, nëse mbetet ndonjë pozicion i lirë (vend vakant), të jetë pjesë e këtij komisioni, pasi për të ka rëndësi të madhe pjesëmarrja në secilin komision.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, deklaroi se, atëherë si zëvendësim kemi Xhavit Drenorin, i cili u vetëpropozua, ndërsa për emrin nga sektori joqeveritar, siç tha edhe Kryetari, e keni të drejtën ju ta gjeni. Nëse jo, atëherë e propozon Kryetari.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci shtoi se, edhe një herë po e përsëris, nëse keni një emër nga shoqëria civile për këtë komision, ju lutem ta propozoni.

Egzona Tërdevci u përgjigj se, parimisht besoj se ju e keni më të lehtë t'i identifikoni, pasi njihni më shumë nga shoqëria civile se ne. Megjithatë, nëse nuk i ngarkojmë shumë, nga përvoja ime në komisione, përfaqësuesit e QPDG-së kanë qenë shumë të përgjegjshëm. Kisha propozuar Kadire Tahirajn, ose le të delegojnë ata dikë tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi konfirmoi se, nga sektori joqeveritar kemi propozimin e Egzona Tërdevcit për Kadire Tahirajn. Pra, edhe një herë për korrektësi, anëtarët e propozuar për komisionin e ankesave të palëve për procedurat në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës janë. Naim Xheli, Egzona Tërdevci, Xhavit Drenori, Petrit Gashi (nga ekzekutivi), Kadire Tahiraj (nga sektori joqeveritar). Kryesuesi e hodhi propozimin në votim. Për votuan 11, kundër 13, vota, abstenim 1. Kjo pikë e rendit të ditës nuk kalon dhe shtyhet për seancën e radhës. Meqenëse pika nr. 6 nuk kaloi, tërhiqet edhe pika nr.7, pasi ato janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, njoftoi kalimin në pikën e radhës:**(8)** Raporti financiar janar–mars 2026. Kryesuesi hapi diskutimin për këtë pikë.

Egzona Tërdevci parashtrroi një pyetje lidhur me pasqyrimin e të hyrave nga prona publike. Në faqet 3 dhe 4 të raportit financiar, paraqiten tre zëra të ndryshëm që kanë të bëjnë me pronat publike. Dy prej tyre janë të emërtuar njëjtë si 'Qiraja publike', mirëpo te njëri figuron vlera prej

13,941.86 euro, ndërsa te tjetri vlera është zero (0). Po ashtu, edhe te zëri 'Shfrytëzimi i pronës komunale', vlera e shënuar është zero (0). A mund të dimë pse janë këto tri ndarje dhe cila prej tyre paraqet saktë pagesat që bëhen për shfrytëzimin e pronës komunale. Po ashtu duke dalë pak jashtë temës, po vërehet se dhënia e pronave në shfrytëzim nuk po duket shumë e leverdishme, pasi shuma e mbledhur nuk ka ndonjë vlerë përmbajtësore financiare për Komunën.

Drejtori i Drejtorisë së Financave, Enver Hoxha sqaroi se, pika e përmendur nga Egzona ka të bëjë me të hyrat nga qiraja. Ai shpjegoi se kur klubet sportive bëjnë kërkesa në Drejtorinë e Kulturës, ato paguajnë qira për shfrytëzimin e fushave sportive dhe sallës së kulturës, por në këtë tremujor nuk ka pasur të hyra të këtij lloji. Ndërsa shuma prej 13 mijë eurosh përfaqëson të hyrat nga qiraja për periudhën janar–mars, sipas programit të përmendur, pra është Drejtorja e Kulturës ajo që i gjeneron këto të hyra nga salla.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, shtoi se, bëhet fjalë për të hyrat afatmesme nga qiratë e lokaleve dhe objekteve sportive që u përmendën më lart. Ai sqaroi se, kjo shumë është e tillë sepse dihet që në tremujorin e parë të vitit ka më së paku pagesa, duke theksuar se kjo nuk lidhet me çështjet e ngritura më herët.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, iu drejtua znj. Tërdevci besoj që morët përgjigje nga drejtori dhe Kryetari. A dëshiron dikush tjetër ta marrë fjalën. Duke qenë se ky është raport, nuk hidhet në votim. Kryesuesi propozoi të kalohet të **Pika (9)** Propozim-vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake nga tejkalimi i vitit 2025 në vitin 2026, si dhe bartjen e fondeve nga bilancet e pashpenzuara të viteve paraprake në vitin 2026. Ai e hapi këtë pikë për diskutim.

Egzona Tërdevci ngriti një pyetje lidhur me bartjen e mjeteve për projektin e rrugës Arllat–Negrovç–Vuçak. Buxheti që kemi planifikuar si Komunë për tri vjet është 104 mijë euro. Nuk e kam të qartë propozimin që keni sjellë për bartjen e 400 mijë eurove, nëse mundet dikush ta sqarojë këtë.

Kryesuesi Burim Bujupi tha se, pyetjes do t'i përgjigjet drejtori Gllareva.

Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës, Endrit Gralleva u përgjigj. E nderuar znj. Tërdevci, vlera totale e kontratës është 700 mijë euro, ndërsa të planifikuara kanë qenë vetëm 100 mijë euro. Kjo bartje ndodh sepse gjatë vitit të kaluar përmbartuesi ka marrë rreth 300 mijë euro, dhe kjo shumë mbetet si obligim i kontratës bazë.

Kryesuesi Burim Bujupi pyeti nëse dëshironte dikush tjetër fjalën. Meqë nuk pati diskutime të tjera, ai e hodhi në votim pikën **(9)**. Për votuan **23**, kundër **1**, abstenim **0**. Pika e rendit të ditës u miratua.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, ftoi të vazhdohet me **Pikën (10)**: Propozim-vendim për formimin e komisionit për plotësim-ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha. Ai tha se, besoj që materialin e keni pranuar të gjithë me kohë. Ky komision përbëhet prej 7 anëtarëve: 3 anëtarë nga ekzekutivi, 3 nga Kuvendi dhe 1 anëtar nga shoqëria civile. Po e

përsëris edhe një herë, nga Kuvendi 1 anëtar i takon PDKRLL-së, 1 PDK-së dhe 1 partive më të vogla opozitare.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha ne, nga ekzekutivi propozojmë Violeta Balecin dhe Fluida Nikën. Për anëtarin nga shoqëria civile po ua lëmë përsëri juve (Kuvendit), por nëse nuk keni propozim, e japim ne emrin.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi vazhdojmë me propozimet nga anëtarët e Kuvendit. Fjalën e ka i pari z. Krasniqi.

Gani Krasniqi tha se, për këtë komision, grupi i PDKRLL-së propozon Qëndresa Xhemën.

Driton Ajazi në emër të grupit të PDK-së, ne propozojmë Artian Krasniqin.

Egzona Tërdevci pas konsultimeve me përfaqësuesit e partive të tjera më të vogla, jemi dakorduar që Liman Krasniqi të jetë përfaqësuesi ynë në këtë komision.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci atëherë, anëtarja e tretë nga ekzekutivi do të jetë Sherije Mustafa. Pra, ekipi i ekzekutivit përbëhet nga: Violeta Baleci, Fluida Nika dhe Sherije Mustafa. Është e domosdoshme që kjo rregullore të ndryshohet sa më shpejt për t'u dalë në ndihmë qytetarëve. Siç kam premtuar edhe gjatë fushatës, synojmë largimin e taksës së operimit për bizneset e mesme dhe të vogla. Ky lirim nuk do të vlejë për subjektet e mëdha si Feronikeli, guroret apo bankat, por për bizneset e vogla që e kanë këtë taksë më të ulët. Besoj se kjo reformë do të jetë në dorën e komisionit dhe tuajën, kur të kthehet si material për miratim në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, atëherë, na duhet edhe një propozim për anëtarin nga shoqëria civile që të plotësohet komisioni.

Driton Ajazi tha se, heqja e taksës po bëhet vetëm pas presionit të bizneseve. Për shkak të këtyre taksave që ju i rikthyet, shumë biznese kanë ikur nga Drenasi për në Fushë Kosovë. Është e pakuptimtë që një market fshati të paguajë 200-400 euro taksë, ndërkohë që asnjë komunë tjetër nuk e aplikon këtë. Pajtohem që bankat dhe guroret të taksohen, por jo biznesi i vogël.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci z. Ajazi, po mashtroni publikun. Dyqanet e vogla nuk kanë pasur kurrë taksë operimi. Nëse thoni që bizneset po ikin në Fushë Kosovë, mi sillni emrat e vetëm 10 bizneseve që janë larguar për këtë shkak. Jam i lumtur që ju kam kundërshtar, sepse me bëni punën shumë me të lehtë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, Kryetar ju lutem na jepni emrin e përfaqësuesit nga shoqëria civile.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, kërkoj mirëkuptimin tuaj, pasi si propozim kemi Arben Nikën. Mirëpo, duhet ta pyesim paraprakisht nëse pranon, për shkak të angazhimeve dhe kontratave që ai ka me donatorë të ndryshëm. Nëse nuk mundet, do të propozojmë dikë tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi bëri të ditur se, derisa të arrijë propozimi për anëtarin nga shoqëria civile për komisionin e rregullores së taksave dhe gjobave, rendi i ditës vazhdon me pikën (11). Ai njoftoi se kjo pikë ka të bëjë me zëvendësimin e z. Xhavit Drenori, i cili ka dhënë dorëheqje nga asociacioni për arsye profesionale dhe personale. Për këtë, ai kërkoi një propozim të ri nga shefi i grupit të PDKRLL-së, z. Krasniqi.

Gani Krasniqi, në emër të grupit të PDKRLL-së, propozoi znj. Qëndresa Xhema si anëtare të re.

Xhavit Drenori, ka sqaruar vendimin e tij për t'u tërhequr nga delegacioni i Komunës së Drenasit në Asociacionin e Komunave të Kosovës, duke u bazuar në dy pika kryesore. Drenori thekson se, anëtarët e kuvendeve komunale që dërgohen në këtë delegacion kanë një rol pothuajse dekorativ. Sipas përvojës së tij, roli i tyre është "gati zero" dhe nuk ka hapësirë për të kontribuar në çështje përmbajtësore për të mirën e komunës. Ai fillimisht nuk kishte interes të ishte pjesë e tij, pikërisht për këtë arsye. Arsyeja e dytë lidhet me sjelljen e Kryetarit të Komunës, i cili para mediave kishte deklaruar se "i ka sjellë dy anëtarë të VV-së" në atë delegacion. Drenori e konsideron këtë deklaratë si të papërshtatshme, pasi e vendos atë në një pozitë të pafavorshme politike. Ai sqaron se pranimi i propozimit fillimisht erdhi si shenjë respekti ndaj votave të kolegëve asamblistë dhe jo si rezultat i ndonjë marrëveshjeje të fshehtë apo politike. Përkundër faktit që fuqia e tij politike (si GRINN dhe në koalicion me VV-në) përfaqësohet me pak vota në Kuvend. Ai vlerëson mbështetjen e kolegëve, por nuk pranon të jetë pjesë e një trupe ku roli i tij është i parëndësishëm, ose ku përdoret për konsum politik nga ekzekutivi.

Egzona Tërdevci, ka adresuar dy çështje kryesore, mohimin e një marrëveshjeje politike me Kryetarin dhe kritikën ndaj ndarjes së brendshme të PDK-së. Ajo sqaron se Vetëvendosja, si subjekti i tretë politik në Drenas, e ka pasur të garantuar me formulë ligjore një vend në Asociacionin e Komunave, prandaj prania e tyre aty nuk është rezultat i ndonjë marrëveshjeje me Kryetarin. Sipas saj, nëse Kryetari ka vendosur të propozojë edhe Xhavit Drenorin (si anëtar të dytë nga radhët e tyre), ky ka qenë vendim i tij dhe jo kërkesë apo marrëveshje me subjektin e VV-së. Ajo u drejtohet dy grupeve të PDK-së (të ndarë në Kuvendin e Drenasit), duke u thënë se kjo ndarje është artificiale dhe po i shkakton telashe komunës. Ajo vë në dukje se në mbledhjet e Asociacionit, kur Kryetari Lladrovci deklarohet si përfaqësues i PDK-së, grupi tjetër nuk reagon. Tërdevci kërkon që të kursehet Kuvendi nga "aktrimi" sikur janë dy grupe të ndryshme (pozitë-opozitë), pasi sipas saj, ata mbeten të njëjtë dhe kanë të njëjtën bazë politike.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, se prania e dy anëtarëve të VV-së në Asociacion nuk ishte thjesht procedurale, por rezultat i vullnetit të tij politik. Ai shton se, të gjithë ata që po na përcjellin, Kuvendi i Asociacionit është i regjistruar dhe është transmetuar live në televizion. Lidhur me pikën e rendit të ditës, ai sqaron se, pas dorëheqjes së Xhavit Drenorit, është propozuar Qëndresa Xhema për të plotësuar vendin e mbetur bosh. Lladrovci shprehet i gatshëm që, nëse VV-ja dëshiron ta mbajë atë pozicion, ai do t'ua japë përsëri. Në rast se VV-ja nuk e pranon, ai ua ofron atë vend katër përfaqësuesve të subjekteve të tjera, me kusht që të ketë kandidatë dhe të votohen nga Kuvendi. Kryetari e paraqet veten si bashkëpunues, duke thënë se u ka ofruar opozitës (VV-së) më shumë hapësirë sesa parashihej, dhe kërkon që pas dorëheqjes së Drenorit, Kuvendi të votojë për zëvendësimin e tij për të vazhduar punën në komision.

Driton Ajazi, desha të mos flas, por nuk mundem pas asaj që tha znj. Tërdevci. E nderuar, qëndrimet e mia dihen. Eshhtë e vërtetë që kam qenë pjesë e PDK-së dhe strukturave të saj që nga viti 2007. Këto qëndrime i dinë të gjithë qytetarët e Drenasit, madje edhe lidershipi i PDK-së. Unë dhe një pjesë e strukturës legjitime, që doli nga procesi zgjedhor i vitit 2019 (strukturë e firmosur nga Kadri Veseli), e kemi mbështetur kryetarin aktual. Mirëpo, ai zgjodhi të qeverisë me njerëz që nuk po ua përmend emrat, të cilët dikur ishin kundërshtarët tanë e që ishin pikërisht me ju. Unë nuk kam qenë pro kësaj, e dashur Egzonë, dhe nuk jam as sot, le të jemi të qartë. Edhe te çështja e Asociacionit, aty ka pasur një hile. Ju keni dashur t'ia ktheni borxhin Xhavitit (Drenorit) që ua ka votuar pronat, andaj e dërguat në Komisionin e Aksionarëve për "EKO Drenas" dhe në Asociacion, vetëm për t'i shlyer borxhin e votës për pronat. Sa u përket këtyre dyve, kur po ju konvenon thonë "jemi VV", e kur nuk ju konvenon, njëri thotë "VV" e tjetri "Guxo" (Green). Ne zyrtarisht mbajmë logon e PDK-së. Në mandatin e kaluar kemi qenë jashtë logos, por le të jemi të qartë, ne jemi PDK me legjitimitet të plotë. Kryetari ka qenë, por është tërhequr, për momentin askush nuk e ndalon të ndjehet si të dojë, por zyrtarisht, ashtu siç nuk isha unë në mandatin e kaluar, as ai nuk është zyrtarisht i PDK-së deri në përfundim të këtij mandati. Ky fakt duhet t'u sqarohet qytetarëve, Kryetarit dhe znj. Tërdevci.

Egzona Tërdevci, mbron qëndrimin e saj se, dy grupet e PDK-së veprojnë si një trup i vetëm jashtë Drenasit. Ajo argumenton se në Asociacion asnjë përfaqësues i grupit të Ajazit nuk e kundërshtoi Kryetarin kur ai u deklarua si përfaqësues i PDK-së, ndonëse zyrtarisht në zgjedhje kishte garuar me një iniciativë tjetër. Ajo sqaron se si ajo, ashtu edhe Xhavit Drenori, në KQZ dhe në Kuvend përfaqësojnë Vetëvendosjen dhe veprojnë si një subjekt i vetëm brenda koalicionit.

Xhavit Drenori, i'u kundërpërgjigjet z. Ajazit duke vënë në dyshim profesionalizmin e tij si asamblist. Ai e konsideron të papranueshme moralisht dhe profesionalisht që një anëtar i Kuvendit të votojë raporte (si ai për vërshimet) pa ua parë përmbajtjen apo detajet brenda. Lidhur me votimin e pronave, ai sqaron se nuk ishte pazar, por rezultat i një insistimi parimor për të ndryshuar afatin e dhënies në shfrytëzim (nga "për 99 vjet" në "deri në 99 vjet"), për të mbrojtur interesin e brezave të ardhshëm.

Driton Ajazi, arsyeton votën e tij për raportet e dëmeve, duke u fokusuar të rezultati praktik. Ai shprehet krenar që ka votuar pro, duke thënë se raportet janë hartuar nga komisionet profesionale me përgjegjësi ligjore. Sipas tij, qëllimi ishte shmangia e burokracisë dhe përsheptimi i rimbursimit për qytetarët e dëmtuar nga vërshimet, siç kërkohej edhe nga Ministria, prandaj "filozofimi" mbi përmbajtjen do të ishte i dëmshëm për interesin e qytetarëve.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, i përgjigjet kritikave mbi legjitimitetin e tij dhe marrëdhëniet me asamblistët. Ai sqaron se, ndonëse në KQZ është regjistruar me iniciativën "Drenasi Kampion", ai mbetet PDK në bindje dhe veprime. Sipas tij, rëndësi ka puna që bën dhe se nuk po e dëmton subjektin e tij. Ai mohon kategorikisht çdo pazar politik me asamblistët (duke iu përgjigjur Ajazit). Lladrovci thekson se, detyra e tij si Kryetar është të sjellë propozime në interes të vendit, ndërsa vendimmarrja u takon asamblistëve në mënyrë të pavarur.

Naim Xheli, kërkon që Kuvendi të mos shndërrohet në arenë fushatash elektorale. Ai insiston se të dyja grupet janë PDK dhe debatet e brendshme po shfrytëzohen nga partitë e tjera për interesat e tyre. Ai vlerëson përfaqësimin e Lladrovcit në Asociacion, duke e quajtur atë dinjitoz dhe besnik ndaj PDK-së.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, i falënderoi të pranishmit për debatin. Meqenëse nuk pati diskutime të tjera, ai e hodhi në votim propozim-ndryshimin. Kush është për Qëndresa Xhemën. Për votuan **24**, kundër **0**, abstenime **0**.

Propozimi kalon dhe Qëndresa Xhema zgjidhet anëtare në Asociacionin e Komunave.

Më pas, **kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi**, kërkoi që të kthehen të Pika (10) Propozim-vendim për formimin e komisionit për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Pas propozimeve nga shefat e grupeve kuvendare për anëtarë të komisionit, kryesuesi prezantoi emrat e propozuar për përbërjen e këtij komisioni si vijon:

Nga Kuvendi Komunal: Qëndresa Xhema, Artian Krasniqi, Liman Krasniqi;

Nga Ekzekutivi: Violeta Baleci, Shehrije Mustafa, Fluida Nika;

Nga Shoqëria Civile: Arben Nika.

Propozimi u hodh në votim dhe u miratua nga të pranishmit në mënyrë unanime.

Kryesuesi u uroi punë të mbarë anëtarëve të komisionit dhe potencoi se duhet të pritët akti i ligjshmërisë për hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, kalojmë të pika e dymbëdhjetë (12) Të ndryshme.

Muhamet Xhemajlaj, paraqiti disa kërkesa dhe shqetësime si vijon. U ngrit shqetësimi për problemet e rënda me ujërat e zeza që derdhen në lumin e fshatrave Abri e Epërme dhe Tërdec. U bë e ditur se prej pesë muajsh mungon ndriçimi publik në lagjen Halilaj. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, deri më tani nuk është gjetur një gjuhë e përbashkët me organet kompetente për zgjidhjen e këtij problemi. Ai kishte një kërkesë nga banorët e Fshati Baicë ku u kërkua hapja e një kanali të "Varrezat e Vrellakut", pasi mbeturinat dhe reshjet e para po shkaktojnë depërtimin e ujit direkt brenda hapësirës së varrezave. Po ashtu u theksua se, rruga pranë hekurudhës në këtë fshat ka degraduar plotësisht. U drejtua një kërkesë e veçantë për rritjen e prezencës së inspektorëve në teren. Shqetësimi kryesor mbetet siguria në punë, duke qenë se çdo muaj po humbim nga një punëtor në sektorin e ndërtimit. U bë thirrje për një bashkëpunim më të ngushtë për të parandaluar këto tragjedi.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, z.Xhemajlaj momentalisht nuk i kemi përgjigjet e gatshme. Ato do t'ju dërgohen përmes postës elektronike (e-mail) ose do t'i merrni në seancën e radhës nga drejtori i Infrastrukturës, z. Ajazi.

Driton Ajazi, realisht, unë kam disa kërkesa nga qytetarët e komunës tonë. Çështja e parë kam pranuar një njoftim nga avokati Sahit Heta lidhur me një pronë prej 19 ari në Zonën Kadastrale në Glllobar. Sipas aktvendimit dhe matjeve kadastrale, kjo pronë fillimisht u ishte caktuar palëve dhe ishte regjistruar në fletën poseduese dhe certifikatë. Mirëpo më pas, në mënyrë arbitrare, kjo

pronë u është marrë përmes Kuvendit dhe u është ndërruar me një lokacion tjetër, duke përdorur matje të reja gjeodezike. Sipas avokatit, lënda tashmë është procesuar në gjykatë. Prandaj kërkoj nga komisioni që do të formohet për shqyrtimin e pronave, që kjo parcelë të merret parasysh dhe të mos procedohet tutje derisa të përfundojnë të gjitha procedurat ligjore. Në seancat e kaluara, kur kemi diskutuar për pronën te hekurudha (ku është vendosur biznesi "IP"), zyrtarët patën deklaruar se nuk kishin njoftim që ajo pronë ishte në procedurë gjyqësore. Tashmë ne e kemi njoftimin zyrtar për këtë parcelë 19 ari në Gllobar, andaj kërkoj që komisioni të ndalojë çdo procedim të mëtutjeshëm për të. Çështja e dytë, kjo pyetje drejtohet për Drejtorin e Urbanizmit, në emër të banorëve të lagjes Gashi (Mëhalla e Xhamisë) në fshatin Arllat. Qytetarët pyesin se pse ende nuk ka filluar asfaltimi i rrugicave në këtë lagje. Banorët kanë bërë kërkesa të vazhdueshme dhe kanë shprehur gatishmëri të plotë për shpronësim, si dhe për respektimin e të gjitha kushteve ligjore. Ju jeni njoftuar shumë herë për këtë çështje dhe keni pranuar kërkesa me shkrim, andaj kur pritet një ndërhyrje konkrete dhe cili është afati i saktë për zgjidhjen e këtij problemi

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, z.Driton po ju përgjigjem lidhur me pronën prej 19 ari. Origjina e asaj prone është e dyshimtë, vendimi për dhënien e saj është bërë pa pëlqimin e Kuvendit dhe në mungesë të ligjshmërisë. Pretendimi se prona u është marrë në këmbim (kompensim) dhe u është dhënë në zonë ndërtimore nuk qëndron ashtu siç po e thoni ju. Nëse keni vendime gjyqësore, është mirë t'i prezantoni këtu, sepse nuk është e vërtetë që ekziston një vendim i tillë. Po të kishte vendim gjyqësor, unë do të isha thirrur nga gjykata. Ne e kemi legalizuar pronën në mënyrë të ligjshme. Kur përmenda më herët formimin e komisionit "Ad Hoc", qëllimi është që ai komision t'i shqyrtojë këto raste dhe pas rekomandimeve, t'i dërgojë lëndët në prokurori. Zyra e pronës i'a ka dhënë atë pjesë përballë rrugës në zonë ndërtimore, duke bllokuar kështu pronën tonë publike prej afro 2 hektarësh. Kuvendi i kaluar ka vendosur t'ia japë atë propozim në atë zonë, por jo në ballin e pronës komunale. Ne kemi shmangur një gabim teknik të zyrtarëve, për të cilin dikush edhe mund të shkonte në burg. Nëse e formoni komisionin, besoj se përgjegjësit do të përballen me ligjin. Për çdo vendim gjyqësor që del, unë do t'i dal përballë. Sa i përket pronës te "IP-ja" që përmendët, çdo pronë që merr konfirmimin e ligjshmërisë nga Ministria e Pushtetit Lokal është e vlefshme njëjtë si prona ku është vendosur stacioni policor në Komoran. Ajo pronë, si çdo pronë tjetër në emër të Komunës, ka kaluar përmes procedurave të rregullta. Lëndët që janë në gjykatë nuk janë për titullin e pronësisë, por për vlerësim të dëmit. Po harrohet se ekziston një vendim i Gjykatës Supreme, pavarësisht nëse ekspertët e nisin dëmshpërblimin nga një milion e dërgojnë në dhjetë milionë euro, ai kthehet në zero. Kjo nuk ka ndikim, sepse procedurat janë kryer shumë vite më parë. Për më tepër nga ajo pronë (te IP-ja), Komuna arkëton 36 mijë euro në vit.

Driton Ajazi, së pari, te çështja e pronës. Kryetar, qytetari nuk ka faj për këto "ekzibicione" procedurale. Atij i është marrë prona kur u bë procesi i këmbimit (kompensimit). Në dosje ekziston një aktvendim gjyqësor i vitit 88/89, mbase nuk ju konvenon, por atij i është ndarë ajo parcelë dhe e ka në fletë poseduese. Ju keni dashur t'ia jepni dikujt tjetër atë pronë komunale për të zhvilluar biznes, kjo është një çështje tjetër, për të cilën gjykata do të vendosë se kush ka pasur të drejtë ju apo qytetari. Kërkesa ime dhe e avokatit ishte që të mos vazhdohet me asnjë procedurë për këtë parcelë derisa gjykata të japë fjalën e fundit. Ndërsa, sa i përket çështjes te "IP-ja" pranë hekurudhës, e tha shumë mirë Kryetari që pamja u rregullua, por keni hequr një

gropë septike. Sipas legjislacionit në fuqi, ju është dashur ta ndërtoni atë gropë diku tjetër, sepse nuk lejohet që ujërat e zeza të qytetit të derdhen direkt në lumë, pra keni bërë shkelje me këtë veprim. Për sa i përket pyetjeve të mia, duhet të më përgjigjet drejtori përkatës dhe jo ju, Kryetar.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, unë jam kryetar për t'i mbrojtur ato. Një lëndë e vitit 88, mos harro se sot jemi në vitin **2026**, i bie që kanë kaluar gati 40 vjet. Edhe nëse ka një fletë poseduese, nëse ajo është me defekt, unë do ta kthej pronën nën komunë edhe 40 vjet pas, sepse detyra ime këtu është të mbroj pronën publike dhe jo ta shkel atë. Prandaj, ka disa që nuk e dëshirojnë formimin e komisionit "Ad Hoc". Sa u përket çështjeve të tjera, deri më sot nuk kam humbur asnjë gjyq për pronat publike të komunës. Për këtë, i falënderoj zyrtarët e komunës, juristët dhe avokaten e komunës. Në veçanti, falënderoj Flamurin, i cili sa ishte shef kabinetit na ka ndihmuar shumë.

Zeq Hasi, kam një shqetësim të banorëve të Drenasit, për të cilin kam diskutuar edhe me Endritin, por dua ta përmend edhe në Kuvend. Punimet që janë kryer nga "VIVA" apo "IP-ja" të varrezat e qytetit janë për keqardhje. Kanë punuar me bager duke shkelur mbi gurët e varrezave dhe kanë këputur pemët, të cilat i kanë hedhur në lumë. Për këtë posedoj edhe fotografi që vërtetojnë shkeljet. Aty janë vendosur tri shtylla elektrike, kërkesa e banorëve është që ato të largohen menjëherë nga hapësira e varrezave. Çfarë është më e keqja, ata kanë punuar ditën e diel, kur nuk punon as Komuna, duke vepruar tërësisht jashtë rregullave ligjore. Qytetarët kanë dashur të dalin vetë për t'i hequr shtyllat, por unë i kam udhëzuar që t'i ndjekim procedurat zyrtare përmes Komunës. Ai pyeti, a ka filluar punën Komisioni për Emërtimin e Rrugëve. Kemi një kërkesë nga një lagje ku rruga është e emërtuar, por emri i saj nuk figuron në sistemet e navigacionit (Google Maps/GPS).

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, edhe unë e ndaj të njëjtin shqetësim me qytetarët për dëmet që janë bërë në varreza. Ato dëme nuk janë shkaktuar nga "VIVA", por nga kompania kontraktore që ka marrë përsipër punimet aty. Lejet i lëshon Komuna, por Inspektorati dhe Policia i kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme. Inspektorati e ka gjositur kompaninë sipas rregullores në fuqi. Ndjej keqardhje, sepse askush nuk ka të drejtë t'i shkelë apo t'i dëmtojë varrezat, ne nuk kemi dhënë leje që ato të dëmtohen me bager. Çdo dëm i shkaktuar do të riparohet nga kompania që ka marrë dënimin. Sa i përket emërtimit të rrugëve, çdo rrugë që ka vendim kontradiktor ose që nuk figuron në Gjeoportali dhe në sistemin GIS, do të shqyrtohet nga komisioni ku bën pjesë edhe Xhavit. Besoj se komisioni do t'i kryejë punët mirë. Shumë emra rrugësh që janë ndërruar në kundërshtim me ligjin para rreth tetë viteve, nëse i ndjekim procedurat, do t'i kthejmë të gjitha në pikën zero. Është mirë të respektohet segmentimi i rrugëve. Nuk duhet që një rrugë, si ajo nga rrethrotullimi të varrezat e Hasve deri në Komoran, të ndahet pa rregull në 3 apo 4 segmente. Kjo është në dorën e komisionit dhe tuajën si Kuvend për të vendosur në të ardhmen. Xhavit, kam vetëm një lutje, asnjë pike nuk i ikim, mirëpo, KKSB-ja (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkëpunim) ka mbledhje ku kanë ardhur Policia, KFOR-i dhe OJQ-të. Prandaj, që mos ta zgjasim, ju lutem bëni pyetjet me shkrim dhe ne do t'ju përgjigjemi për të gjitha ato që kemi informacion.

Xhavit Drenori, po flas në emër të komisionit, ku jam edhe kryesues. Kemi një ekip shumë të mirë dhe po punojmë me kapacitetin tonë maksimal. Jemi pothuajse gati për të filluar punën në

teren. Duhet ta sqarojmë se segmentimin nuk e bëjmë ne si komision. Segmentimi bëhet përmes sistemit GIS, andaj ju lutem drejtojuni zyrtarëve përkatës për këtë pjesë teknike. Detyra jonë si komision është vetëm shqyrtimi i kërkesave që kanë parashtruar banorët. Kam një lutje për të gjithë anëtarët e Kuvendit, përfshihuni që në këtë fazë kur ne i thërrasim banorët në telefon dhe u themi se kërkesa po procedohet, kemi nevojë që ju të mos i rrëzoni ato propozime më pas në Kuvend. Kjo na vendos ne si komision në pozitë të vështirë, sepse është një punë e rëndë. Na ndihmoni që në fillim për lokacionet tuaja, që të bëhet më e mira për banorët. Një gjë duhet të jetë e qartë, mos u premtoni njerëzve se mund t'u ndryshojmë emrat e rrugëve ekzistuese. Sipas rregullores që na ka ardhur nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ndryshimi i emërtimeve është i pamundur deri në vitin 2029.

Luljeta Elshani, ngrita dy çështje kryesore. Të gjithë e dimë se, pas reagimit tim, dy ditë para zgjedhjeve, kjo rrugë është shtruar me zhavorr. Përmes rrjeteve sociale, administratori së bashku me z. Nexhmedin kanë premtuar se brenda një viti ajo rrugë do të rregullohet plotësisht. Sot jemi shtatë muaj pas atij premtimi dhe ende nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim. Pyetja ime është. A është kjo rrugë e përfshirë në planin buxhetor dhe kur pritet asfaltimi e ndriçimi i saj. Sa i përket çështjes së urës, Kryetar, ne dimë që ju keni mbajtur tri qëndrime.

1. Se Komuna nuk ka buxhet për ndërtimin e saj.
2. Se nuk keni pranuar që FSK-ja të ndërtojë një urë të përkohshme, me arsyetimin se ajo mund të mbetet ashtu përgjithmonë.
3. Se kjo çështje është në diskrecion të Qeverisë që ta ndërtojë urën. Qytetarët duan ta dinë, a ka ndonjë zhvillim të ri konkret për rregullimin e kësaj ure.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, po ju përgjigjem lidhur me rrugën te varreza. As nuk keni bërë presion ju, as nuk mund të bëni, sepse në ato varreza janë të varrosur dëshmorë që janë miq të mi të organizimit të hershëm prej para 40 viteve. Ne e kemi shtruar atë rrugë jo nga presioni, por sepse është e domosdoshme dhe e ligjshme. Ju e dini që fillimisht nuk kemi pasur buxhet deri në fund të marsit. Në prill, mjetet na i ka marrë përmbaruesi, pa buxhet, as atë rrugë e as urën nuk mundemi t'i realizojmë. Sa i përket urës, ne kemi qenë transparentë dhe i kemi bërë kërkesë Qeverisë. Ura është dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe ne nuk kemi pasur asnjë cent të paraparë për të, prandaj po presim përgjigjen nga niveli qendror. Nëse Qeveria ndan buxhet, unë i kam dhënë urdhër Drejtorisë së Infrastrukturës që të nisë procedurat e shpronësimit për themelin e urës. Ura e re duhet të plotësojë standardet, do të jetë me dy korsi dhe me trotuar, ndryshe nga ajo e vjetra që kishte vetëm një kalim dhe nuk kishte trotuar fare. Do t'i shohim procedurat në korrik dhe gusht, nëse kemi buxhet, do ta bëjmë vetë. Fatmirësisht nuk kemi bllokadë të rrugëve. Dje i kemi dërguar përsëri kërkesë Ministrisë, por na është thënë se lënda është ende "në shqyrtim". Shpresoj që deri në mbledhjen e ardhshme procedurat të përfundojnë dhe ta vendosim urën sipas projektit tonë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, unë kërkoj nga ana e qytetarëve dhe drejtorve me pas durim, më dëgjoni, Driton, ajo që i kam thënë Idrizit është një temë që as nuk po e mohoj, as nuk po e pohoj. Unë shpeshherë kam dëshirë të bëj diçka para kohës, por interesi i qytetarëve është parësor. Te varrezat na rastis të shkojmë një apo dy herë në vit, ndërsa rrugët e lagjeve të Krajkovës kanë qenë të papërfunduara dhe, fatmirësisht, tani i kemi përfunduar.

Artian Krasniqi, kam një pyetje për drejtorin Gllareva lidhur me gjendjen e rrugës "Skënder Mulaku", e cila lidh (Komoranin III me Kishnarekën). Ajo rrugë është në gjendje të tmerrshme. Pyetja ime është. A keni ndonjë plan konkret për sanimin e gjendjes në atë aks rrugor.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, rruga që lidh Komoranin me Komoranin III, është e dëmtuar, ashtu siç janë edhe shumë rrugë të tjera. Drejtoria e Shërbimeve Publike do të bëjë një vlerësim për të parë nëse është për riparim, mirëpo ne kemi pasur mungesë buxheti. Për shkak të mungesës së mjeteve, nuk kemi pasur mundësi të paguajmë as ndriçimin publik në shumë fshatra, andaj KEDS-i na e ka ndërprerë rrymën. Mjetet i kemi pasur, por na i ka marrë përmbaruesi nga ato kode buxhetore, sepse Qeveria po vendos vetë se ku t'i marrë mjetet për të na goditur më së shumti. Besoj se nesër do të dalim bashkë për të kërkuar votat për deputetët e PDK-së nga Drenasi. Qeveria ka votuar një ligj bashkë me buxhetin i cili i lejon asaj t'i marrë paratë ku të dojë, pa e pyetur fare komunën. Kjo po na godet rëndë, ne paguajmë 35 euro për çdo kyçje në një segment të dritave. Nuk e di sa jeni në dijeni, por përmbaruesit u kanë marrë komunave të Kosovës rreth 300 deri në 400 milionë euro. Edhe neve na janë marrë shuma të mëdha, dhe pa para ne nuk mund të zhvillojmë projekte të reja.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi konstatoi se, pasi nuk pati diskutime të tjera dhe e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi